



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2870/ 4 prot.

Datë 29.12.2022

V E N D I M
Nr. 1306 /2022

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiovent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 29 .12.2022, shqyrtoi kërkesën me:

Objekt: Kërkesë për heqje dorë nga shqyrtimi administrativ i ankesës nr. 2870 prot., datë 27.12.2022 të paraqitur nga “KREATX” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF-49642-11-11-2022, me objekt: “*Përditësim i Programit të Faturimit, Migrim i të dhënave dhe web-service për pagesat e faturat e ujit të pijshëm*” me fond limit 9,500,000. lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 07-12-2022 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Ujësjetllës Kanalizime Fier.

Ankimues: Operatori ekonomik “KREATX” SHPK
Adresa: Njësia Bashkiake nr. 5, Rruga Tish Daija, Kompleksi Kika 2, Godina 1, Shkalla 1, Zyra nr.2

Autoriteti Kontraktor: Ujësjetllës Kanalizime Fier SH.A.
Adresa: Lagja “1 Maj”, Rr. ”Tasi Dema

Subjekte të Interesuara: Operatori ekonomik “PRIMUS ALBANIA” SHPK
Adresa: Tiranë, Rruga Margarita Tutulani, pallati Viridario 1.

Baza Ligjore: Nenet 30 dhe 117 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi

i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr.500/2020, datë 05.11.2020 “Rregullore për marrjen e masave organizative për ushtrimin e veprimtarisë së institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID-19”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi kërkesën e ankimuesit dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, si dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë në mënyrë elektronike në Sistemin e Ankesave Elektronike.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 14.11.2022, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-49642-11-11-2022, me objekt: “Përditësim i Programit të Faturimit, Migrim i të dhënave dhe web-service për pagesat e faturat e ujit të pijshem” me fond limit 9,500,000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 07-12-2022 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Ujësjellës Kanalizime Fier.

II.2. Në datën 27.12.2022 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është paraqitur në mënyrë elektronike në Sistemin e Ankesave Elektronike ankesa me nr. A/2022/2792, protokolluar me nr. 2870/2022, datë 27.12.2022 e operatorit ekonomik “KREATX” SHPK për procedurën e prokurimit të sipërpërmendur.

II.3 Bazuar në nenin 112, pika 4 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, Komisioni i Prokurimit Publik publikoi “Formularin për Publikim” me Nr. 2870/2 prot., datë 28.12.2022, me objekt kundërshtim të vendimmarrje së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “PRIMUS ALBANIA” SHPK.

II.4. Në datën 29.12.2022, operatori ekonomik ankimues “KREATX” SHPK, me anë të shkresës protokolluar me tonën me nr. 2870/3 prot., datë 29.12.2022, ka paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik kërkesë me anë të së cilës kërkon: “Në vijim të ankimit tonë me Nr. A/2022/2792, ju komunikojmë se Shoqëria “KREATX” SHPK heq dorë nga ky ankim dhe kërkojmë që ai të mos merret në shqyrtim.” në lidhje me procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-49642-11-11-2022, me objekt: “Përditësim i Programit të Faturimit, Migrim i të dhënave dhe web-service për pagesat e faturat e ujit të pijshem” me fond limit 9,500,000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 07-12-2022 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Ujësjellës Kanalizime Fier

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të kërkesës së operatorit ekonomik ankimues,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me kërkesën me objekt “Tërheqje nga Ankesa” e operatorit ekonomik ankimues “KREATX” SHPK për të hequr dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-49642-11-11-2022, me objekt: “Përditësim i Programit të Faturimit, Migrim i të dhënave dhe web-service për pagesat e faturat e ujit të pijshem” me fond limit 9,500,000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 07-12-2022 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Ujësjellës Kanalizime Fier, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në nenin 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet:

“1. Ankimuesi ka të drejtë që të tërheqë ankesën e depozituar në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e saj nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Tërheqja e ankesës konsiderohet si mospranim ankese dhe ankimuesit nuk i kthehet tarifa e ankesës.

2. Në rast të tërheqjes së ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik ndërpret shqyrtimin e saj menjëherë dhe merr vendim për mbylljen e çështjes.”

III.1.2. Bazuar në parashikimet e mësipërme ligjore, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues është në të drejtën e tij, që në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, të kërkojë të heqë dorë nga pretendimet e parashtruara në ankimin e tij. Në këto kushte, nisur nga kërkesa e operatorit ekonomik ankimues për heqje dorë nga ankesa e bërë, në zbatim të pikës 2, të nenit 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik do të

ndërpresë menjëherë shqyrtimin e ankesës nr. 2870 prot., datë 27.12.2022 dhe nr. ankimimi elektronik A/2022/2792 datë 27.12.2022 për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi si dhe do të mbyllë çështjen administrative.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të përfundojë procedimin administrativ për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-49642-11-11-2022, me objekt: “Përditësim i Programit të Faturimit, Migrim i të dhënave dhe web-service për pagesat e faturat e ujit të pijshëm” me fond limit 9,500,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 07-12-2022 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Ujësjetës Kanalizime Fier.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “KREATX” SHPK.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar

Fiorent Zguro

Anëta

Kreshnik Ternova

Kryetar

Jonaid Myzyri